

## PLATFORMA CIVIKOS

### PËRMBAJTJA

### FAQJA

RAPORTI I AUDITORIT

BILANCI I GJENDJES

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

1

2

3

4

5 - 12

## PLATFORMA CIVIKOS

### PËRMBAJTJA

### FAQJA

RAPORTI I AUDITORIT

BILANCI I GJENDJES

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

1

2

3

4

5 - 12



## RAPORTI I AUDITORT TË PAVARUR

### Për Bordin e Drejtorëve të Platforma CIVIKOS (CIVIKOS)

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Platforma CIVIKOS, për fundin e vitit më 31 dhjetor 2013, të cilat përmbajnë bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rredhjes së parasë, dhe tjerë shënime shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, në përputhje me politikat kontabël të aprovuara në Republikën e Kosovës. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me rrethanat.

#### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim të marrjes së provave të auditimi për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin ato rezultat i mashtrimeve apo pasaktësive. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë bazë të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të PLATFORMA CIVIKOS më 31 Dhjetor 2013 dhe rezultatit e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me politikat kontabël të aprovuara në Republikën e Kosovës.

Armend Osaj – Statutory Auditor  
ACA – Audit & Consulting Associates  
Priştinë, Kosovë  
Mars 2014



**PLATFORMA CIVIKOS**  
**Bilanci i gjendjes**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013**

	Shënimi	31-Dhjetor-13 (në EUR)	31-Dhjetor-12 (në EUR)
<b>ASETET</b>			
<b>Asetet jo-qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe paisjet	3	-	-
<b>Totali i aseteve jo-qarkulluese</b>		-	-
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		-	-
Të arkëtueshme tjera		423	-
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4	31,792	31,121
<b>Totali i aseteve qarkulluese</b>		32,215	31,121
<b>TOTALI I ASETEVE</b>		<b>32,215</b>	<b>31,121</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>			
Ll. e pagueshme		500	400
Të hyrat e shtyera	5	31,655	30,722
Detyrime Tjera		60	-
<b>Totali i detyrimeve rrjedhëse</b>		32,215	31,121
<b>Detyrimet jo-rrjedhëse</b>			
<b>Totali i detyrimeve jo-rrjedhëse</b>		-	-
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali		-	-
Mbetjet nga vitet e kaluara		-	-
Mbetjet nga viti aktual		-	-
<b>Totali i ekutetit</b>		-	-
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT</b>		<b>32,215</b>	<b>31,121</b>

Pasqyrat financiare janë nënshkruar më 24 Mars 2014 nga:

  
**Valdete Idrizi**  
 Drejtoreshë Ekzekutive



Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

## PLATFORMA CIVIKOS

### Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

		Fundi vitit 31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	Fundi vitit 31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
	Shënimi		
<b>Të hyrat</b>			
Soros dhe Komisioni Evropian	6	86,376	57,572
<b>Totali i të hyrave totale</b>		<b>86,376</b>	<b>57,572</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shp e administratës	7	26,937	10,085
Shpenzimet e programit	8	24,233	24,887
Pagat dhe benefitet	9	35,206	22,600
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>86,376</b>	<b>57,572</b>
<b>Pjesa e mbetur</b>		<b>-</b>	<b>-</b>

**PLATFORMA CIVIKOS****Pasqyra e rrjedhës së parasë****Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013**

	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor, 2013 (në EUR)</b>	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor, 2012 (në EUR)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese</b>		
(Deficiti)/mbetja për periudhën	-	-
Rregulluar për:		
Zhvlerësimi	-	-
Ndryshimet në të arkëtueshme	-	-
Ndryshimet në të arkëtueshme tjera	(423)	-
Ndryshimet në të pagueshme	100	400
Ndryshimet në të pagueshme tjera	60	
Ndryshimet në të hyra të shtyera	934	(7,972)
<b>Paraja neto nga aktivitetet operuese</b>	<b>670</b>	<b>(7,572)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
<b>Paraja neto e përdorur në investime</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent</b>	<b>670</b>	<b>(7,572)</b>
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	31,121	38,693
<b>Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor</b>	<b>31,792</b>	<b>31,121</b>

## **PLATFORMA CIVIKOS**

### **Shënimet e pasqyrave financiare**

#### **Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013**

---

#### **1. Hyrje**

Platforma CIVIKOS është një nismë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë e ka filluar në fillim të vitit 2007 dhe është regjistruar zyrtarisht më 2 shtator 2007, për qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për bashkëpunim e sektorit zyrtar të shoqërisë civile dhe Qeverisë së Kosovës .

Mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur , me pjesëmarrjen e shumë anëtarëve të CSO dhe zyrtarëve të qeverisë , kjo iniciativë u lancua zyrtarisht në korrik 2007 . Ndër të tjera , platforma CIVIKOS , pas një procesi të gjatë të konsultimit me pjesëmarrjen e mbi 130 organizatave të shoqërisë civile , më 9 nëntor 2007 ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile ( e përfaqësuar nga Platforma CIVIKOS) . Ky memorandum përfaqëson dokumentin e parë zyrtar që ofron për një angazhim të ndërsjellë dhe bashkëpunimit institucional në partneritet të mirëfilltë mes qeverisë dhe shoqërisë civile.

Pas një periudhe të aktiviteteve të kufizuara , gjatë muajit Maj 2010 Bordi i Platformës CIVIKOS vendosi të angazhohet në aktivitete shumë konkrete për të forcuar Platformën me qëllim promovimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në një Strategji për bashkëpunim mes Qeverisë së Kosovës dhe të shoqërisë civile , i cili do të paraqiste një dokument bazë për kthimin e premtimeve të marra në veprimet dhe rezultatet konkrete .

Me këtë iniciativë , gjatë vitit 2010 dhe 2011 Platforma CIVIKOS u fokusua në forcimin e saj të brendshëm , ndër të tjera duke organizuar kuvendin e anëtarëve , konsolidimin e dokumenteve të saj për funksionalitetin me sukses të platformës dhe gjithashtu duke zgjedhur struktura te reja udhëheqese dhe menaxheriale.

Platforma CIVIKOS ka qenë e angazhuar në inicimin e dialogut me Qeverinë e Kosovës drejt strukturimit te bashkëpunimit në mes shoqërisë civile dhe sektorit të qeverisë. Në këtë drejtim pengesa kryesore ishte vakumi institucional e krijuar në Kosovë në fund të vitit 2010 dhe fillim të vitit 2011, si pasojë e procesit të gjatë të zgjedhjeve dhe vonesa në krijimin e institucioneve qeveritare. Gjatë vitit 2011 janë organizuar takime të shumta me organizatat anëtare ku çështjet kryesore qe u adresuan dhe diskutuan ishin mbi bashkëpunim me sektorin qeveritar. Rezultati kryesor që rrjedhi nga kjo fazë përgatitore është se Platforma CIVIKOS ka hartuar Kornizën e Strategjisë për bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, një dokument të brendshëm të platformës e cila reflekton pozicionin e konsoliduar e anëtarëve të saj për komponentë të ndryshëm të këtij bashkëpunimi.

Gjatë këtyre dy viteve të fundit, platforma CIVIKOS ka organizuar një numër të konsultimeve me organizatat e shoqërisë civile, kryesisht organizatat anëtare, jo vetëm për objektivat e strategjisë, por edhe kanë përgatitur një numër të analizave dhe studimeve për çështje të ndryshme të cilat do të inkorporohen në Strategjinë e bashkëpunimit, duke ofruar një bazë profesionale të informacionit dhe njohurive për të hartuar një dokument serioz për bashkëpunim.

Gjatë vitit 2013 Platforma CIVIKOS filluar të zbatojë një projekt një *"Working Together. Towards a productive working relation between civil society and the authorities in Kosovo"*, një projekt i financuar nga BE menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Objektivi kryesor i këtij projekti është të kontribojë në qeverisjen e mirë, integrim evropian, dhe një shoqëri civile te gjallë në Kosovë përmes sigurimit të bashkëpunimit të mirë midis shoqërisë civile dhe autoriteteve në Kosovë.

## **PLATFORMA CIVIKOS**

### **Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdimi)**

**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013**

---

Gjithashtu, më 5 korrik 2013 Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë e saj të parë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2013-2017). Qëllimi i Strategjisë është krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit të strukturuar në mes Qeverisë së Kosovës dhe sektorit të shoqërisë civile. Platforma CIVIKOS ka qenë duke luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e konsultimit dhe hartimin e kësaj Strategjie në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë. Të dyja, Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë dhe CIVIKOS së bashku do të koordinojë zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.



## **PLATFORMA CIVIKOS**

### **Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdimi)**

**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013**

---

## **2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL**

### **2.1 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur për qëllime të raportimit në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe paraqesin një pasqyrë të plotë të ngjarjeve ekonomike që kanë ndodhur në "CIVIKOS" gjate 2013.

### **2.2 Valuta e përdorur**

Valuta e raportimit e CIVIKOS është valuta e Bashkësisë Evropiane Euro ("EUR").

### **2.3 Politikat e rëndësishme kontabël**

Një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël të adaptuara për përgatitjen e pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë

#### **2.3.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saja**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shume se tre muaj.

#### **2.3.2 Llogarite e arkëtueshme**

Llogarite e arkëtueshme regjistrohen në anën e aseteve të bilancit të gjendjes në vlerë si janë faturat, dhe ato përfaqësojnë shumat që duhet të paguhen CIVIKOS.

#### **2.3.3 Prona dhe pajisjet**

CIVIKOS ka politikë për të paraqitur të gjitha pajisjet të blera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Prandaj ato nuk janë kapitalizohen as zhvlerësohen. CIVIKOS mban vazhdimisht përditësime në një listë të aseteve të saj.

#### **2.3.4 Njohja e të ardhurave**

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura mbi një bazë lineare gjatë periudhës së operimit.

#### **2.3.5 Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet e kryera për të gjenerimin e të ardhurave janë njohur në atë periudhë me kostot historike

#### **2.3.6 Tatimet**

CIVIKOS u themelua si një organizatë jo-fitimprurëse dhe punon sipas rregulloreve të Kosovës për Organizatat jo qeveritare nr. 04/L-057, viti 2011.

## PLATFORMA CIVIKOS

### Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdimi)

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

#### 3. PRONA DHE PAJISJET

Organizata trajton blerjen e asetëve si shpenzime. Prandaj, ato nuk janë të kapitalizuara dhe nuk zhvlerësohen.

#### 4. PARAJA DHE GJENDJA NË BANKA

	31 Dhjetor , 2013 (në EUR)	31 Dhjetor, 2012 (në EUR)	31 Dhjetor, 2011 (në EUR)
Paraja e gatshme	242	1	60.01
Paraja në bankë	31,550	31,120	38,633
<b>Totali parasë dhe gjendjes në bankë</b>	<b>31,792</b>	<b>31,121</b>	<b>38,693</b>

Gjatë kësaj periudhe CIVIKOS ka patur dy llogari bankare të hapura në ProCredit Bank Kosovë.

#### 5. TË HYRAT E SHTYERA

	31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
Soros 012/11	-	4,227
Soros C06/12	6,665	26,494
Soros C14/13	3,192	-
Komisioni European	21,798	-
<b>Totali i të hyrave të shtyera</b>	<b>31,655</b>	<b>30,722</b>

Të hyrat e shtyera për vitin 2013 janë të lidhura me fondet e marra gjatë vitit 2013, të cilat kanë pasur të mbahen në vitin e ardhshëm fiskal. Një ndarje e të hyrave të shtyera për projekte të veçanta është paraqitur më poshtë

EUR	Soros 012/11	Soros C06/12	Soros C14/13	Komisioni European	Totali
Bilanci më 31 Dhjetor 2012	4,227	26,494	-	-	30,722
Shtimet në 2013	-	-	9,852	77,518	87,370
Të hyrat e njohura në 2013	(4,227)	(19,829)	(6,660)	(55,720)	(86,436)
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>-</b>	<b>6,665</b>	<b>3,192</b>	<b>21,798</b>	<b>31,655</b>

## PLATFORMA CIVIKOS

### Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdimi)

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

#### 6. TË HYRAT

	31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
Soros 012/11	4,168	18,997
Soros 420/11	-	19,696
Soros C06/12	26,494	49,600
Soros C14/13	9,852	-
Komisioni European	77,518	-
Të hyrat e shtyera	(31,655)	(30,722)
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>86,376</b>	<b>57,572</b>

#### 7. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
Komunikimi (internet, telefoni)	1,999	610
Karburant	934	338
Qiraja, Shërbimet Komunale	9,600	4,000
Shpenzimet e zyrës	1,223	3,033
Pajisjet	3,680	973
Takimet e bordit	92	958
Shpenzimet Bankare	108	173
Tjera	9,300	-
<b>Totali i shpenzimeve administrative</b>	<b>26,937</b>	<b>10,085</b>

## PLATFORMA CIVIKOS

### Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdimi)

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

#### 8. SHPENZIMET E PROGRAMIT

Tek "Auditimi" janë përfshirë shpenzimet e auditimit për vitin 2012 në shumë prej 812 € dhe për vitin 2013 në shumë prej 500 €.

	31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
Personeli	11,484	1,947
Shpenzimet e zyrës	378	236
Pajisjet	-	958
Përkthimi	890	656
Printimi	1,337	274
Telefoni	586	149
Shpenzimet e dokumenteve politike	2,000	9,944
Shpenzimet e trajnimeve	-	1,032
Kostot e reprezentimit	336	647
Mirembajtja e webfaqes	-	550
Udhëtimet	3,219	3,535
Akomodimet	1,224	4,000
Workshops	1,463	956
Auditimi	1,312	-
Shpenzimet bankare	5	-
Mirembajtja	-	4
<b>Totali nga shpenzimet e programit</b>	<b>24,233</b>	<b>24,887</b>

#### 9. PAGAT DHE BENEFITET

	31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
Drejtori Ekzekutiv	10,807	11,400
Koordinatori i Projektit	8,755	7,200
Menaxheri i Financave	8,117	4,000
Menaxheri i Komunikimit dhe infor.	3,600	-
Monitorimi dhe Vleresimi	3,000	-
Praktikantët	928	-
<b>Totali nga pagat dhe benefitet</b>	<b>35,206</b>	<b>22,600</b>

## PLATFORMA CIVIKOS

### Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdimi)

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

#### 10. TOTALI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE SIPAS PROJEKTEVE

	<u>SOROS 012/11</u>	<u>SOROS C06/12</u>	<u>Komisioni European</u>	<u>C14/13</u>	<u>Totali</u>
Hyrjet	4,168	19,829	55,720	6,660	86,376
<b>Totali i hyrjeve</b>	<b>4,168</b>	<b>19,829</b>	<b>55,720</b>	<b>6,660</b>	<b>86,376</b>
<b>Shpenzimet</b>					
Shpenzimet administrative	48	1,769	24,737	383	26,937
Shpenzimet e programit	4,120	12,010	8,104	-	24,233
Pagat dhe benefitet	-	6,050	22,880	6,277	35,206
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>4,168</b>	<b>19,829</b>	<b>55,720</b>	<b>6,660</b>	<b>86,376</b>
<b>Neto Mbetja / (Deficiti) per vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

#### 11. PALËT E NDËRLIDHURA

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloj palën tjetër, apo nëse njëra prej tyre ka ndikim në palën tjetër gjatë marrjes së vendimeve financiare apo operuese siç është cekur në SNK 24 "Shpalosja e palëve të ndërlidhura". Në vështrimin e mundësisë së ekzistimit të palëve të ndërlidhura, vëmendja është përqëndruar në aspektin e marrëdhënies e jo në aspektin legal.

#### 12. MENAXHIMI I RISKUT

##### *Kredit risku*

Kredit Risku është risku që njëra palë me dështimin në përmbushjen e obligimeve financiare do ndikojë në palën tjetër të ketë humbje financiare. CIVIKOS nuk ka qenë i ekspozuar ndaj këtij rreziku gjatë 2013.

##### *Normat e interesit*

CIVIKOS momentalisht nuk është i ekspozuar ndaj rrishtit ndaj normave të interesit.

##### *Risku nga këmbimet ndërkombëtare*

CIVIKOS nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor sepse transaksionet janë ndërmarrë të gjitha në valutën vendore. Menaxhmenti i monitoron dhe vendos limitet për nivelin e ekspozimit të tillë sipas valutës dhe në total. CIVIKOS nuk spekulon dhe nuk angazhohet në tregtimin e instrumenteve financiare derivative.

## **PLATFORMA CIVIKOS**

### **Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdimi)**

**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013**

---

#### ***Risku i likuiditetit***

Risku i likuiditetit paraqet riskun kur pjekuria e pasurisë dhe e detyrimeve nuk përputhen. CIVIKOS monitoron likuiditetin e saj në baza periodike, në mënyrë që të menaxhoj obligimet e sajë në momentin kur duhet të paguhen.

#### ***Vlerat e drejta te pasqyrave financiare***

Vlera kontabël e të gjitha aseteve dhe detyrimeve financiare të reflektuara në pasqyrat financiare është e përafërt me vlerën e tyre reale.

STATISTICAL ANALYSIS

Method of Moments Estimation

For a random variable  $X$  with density function  $f(x)$

and moments

$\mu_k = \int_{-\infty}^{\infty} x^k f(x) dx$  for  $k = 1, 2, \dots$

the method of moments estimates the parameters of the distribution by equating the sample moments to the population moments

and solving for the parameters

For example, if  $X$  is normally distributed with mean  $\mu$  and variance  $\sigma^2$

the method of moments estimates  $\mu$  and  $\sigma^2$  by equating the sample mean and variance to the population mean and variance

and solving for  $\mu$  and  $\sigma^2$